



Datë: 10.03.2025
Numër Protokolli: 1837/2025

A.nr.31/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Ardita Haxhinikaj-Demi-anëtare dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ylber Fetahaj-në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.31/2025 të datës 08.01.2025 të parashtruar nga grup ankuesish në përbërje prej 64 (gjashtëdhjetekatër) zyrtarë të punësuar në Komunën e Vitisë, ankesë e cila në Këshill është e regjistruar në emër të ankuesit I.S, ndërsa me autorizim i përfaqëson Avokat Esat Syla, nga Komuna e Skenderajt, kundër organit të punësimit/Komuna e Vitisë, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa, A.nr.31/2025 e datës 08.01.2025, e parashtruar nga ankuesit: I.S; Sh.Z; A.K-Z; A.I; Z.M; D.M; S.S; H.H; F.D; A.M; B.L; Xh.H; A.S; V.S; R.SH; Q.K; N.H; Sh.K; R.O; M.S; D.H; Xh.M; M.I; A.A; Xh.H; E.SH; S.D; L.H; I.H; S.M; F.D; B.Z; Sh.A; I.S; D.H; H.Y; A.M-H; B.XH; L.J; L.Z; A.A; Z.B; N.GJ; Xh.SH; F.H; M.A; Xh.LL; A.SH; A.S; I.F; Z.A; B.M; B.A; S.B; H.Y; E.I; E.P;

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për tëvendosur për ankesën, A.nr.31/2025 të datës 08.01.2025 të parashtruar nga ankuesit: F.E ; S.I; D.A; A.J; N.L; K.I; B.B;

III. Lënda e ankuesve sipas pikën II të dispozitivit të këtij vendimi bie në kompetencë për shqyrtim Komisionit për Ankesa në Komunën e Vitisë, të cilit organ i dërgohet kjo lëndë që ndërlidhet me ankuesit si në pikën II të dispozitivit.

A r s y e t i m

Ankuesit si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij vendimi, përmes përfaqësuesit të tyre Avokat ESAT SYLA. më datë 01.01.2025 përmes shërbimi postar, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 08.01.2025 dhe është regjistruar me numër A.nr.31/2025 dhe numër protokolli 54/2025, kundër Komunës së Vitisë, me të cilën kërkojnë shtesën në pagë prej 0.5% nga data 06.02.2023 e tutje, shtesat SHCK në pagë 31.20 euro në muaj për secilin nëpunës nga data 06.02.2023 e tutje ashtu siç kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, dhe shujtat nga 4 euro për secilën ditë të pranisë në punë nga viti 2021 e deri më tani duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë me Nr. 08/48 të datës 09.09.2015.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.01.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vitisë, ndërsa kjo e fundit më datë 07.02.2025 ka dërguar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura. .

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesit si në **pikën I** të dispozitivit të këtij vendimi, posedojnë Akte të Emërimit dhe rrjedhimisht të gjithë kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil, dhe janë të punësuar në kuadër të Komunës së Vitisë.

Ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar Avokat ESAT SYLA, më datë 08.10.2024, kanë parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë, me të cilën kanë kërkuar: Shujtat për ditët e pranisë në punë për secilin zyrtar të kësaj komune duke u bazuar në Vendimin e Qenësisë së Kosovës si fakt noter; Shtesat në pagë për secilin nëpunës të kësaj komune prej 0.5% për vitet e përvojës në punës nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë ndërlidhur me nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KO79/23 të datës 23.01.2024; Shtesat-SHCK në pagë nga 31.20 euro në muaj për secilin nëpunës, ashtu siç i kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave Nr. 08/L-196 të datës 05.01.2023.

Ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar Avokat ESAT SYLA, më datë 11.11.2024, kanë bërë kërkesë të ripërsëritur të cilën sipas librit të regjistrit të shkresave hyrëse, Komuna e Vitisë e ka pranuar me datë 19.11.2024, në kërkesën për kompensim material për Shujtat për ditët e pranisë në punë për secilin zyrtar të kësaj komune, duke u bazuar në Vendimin e Qenësisë së Kosovës si fakt noter; Shtesat në pagë për secilin nëpunës të kësaj komune prej 0.5% për vitet e përvojës në punë, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KO79/23 i datës 23.01.2024; Shtesat-SHCK në pagë nga 31.20 euro në muaj për secilin nëpunës, ashtu siç i kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave Nr.08/L-196 të datës 05.01.2023.

Ankuesit përmes Avokat ESAT SYLA. në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se pas kërkesave të përsëritura, nuk kemi pranuar përgjigje nga Komuna e Podujevës, duke kërkuar që të aprovoj ankesën e tyre dhe të obligoj Komunën e Vitisë që të njohë këto të drejta gjegjësisht kompensimin e shtesës në pagë prej 0.5% nga data 06.02.2023 e tutje, shtesës SHCK në pagë 31.20 euro në muaj për secilin nëpunës nga data 06.02.2023 e tutje ashtu siç kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, dhe shujtat

nga 4 euro për secilën ditë të pranisë në punës nga vitit 2021 e deri në tani duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë me Nr. 08/48 të datës 09.09.2015.

Kolegji i Këshillit bazuar në provat e lëndës konstaton se ankuesit e përcaktuar si në **pikën I** të dispozitivit të këtij vendimi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk i referohen asnjë kërkesë të parashtruar tek Komuna e Vitisë mirëpo i referohen vetëm kërkesave të ripërsëritura, dhe me rastin e parashtrimit të ankesës kanë dërguar vetëm një faqe të kërkesës, ndërsa Komuna e Vitisë më rastin e përgjigjes në ankesë ka dorëzuar dy prova të lëndës, dy kërkesa të parashtruar nga ankuesit ajo e datës 08.10.2024 dhe ajo e datës 19.11.2024, e të cilat për nga përmbajtja e tyre, gjejmë tek kërkesat për njohjen e kompensimeve apo të drejtave janë të njëjta. Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimet e palëve për heshtje administrative me qëllim të konstatimit të pranueshmërisë së ankesës ju referua dispozitave të ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 98 me të cilin përcaktohet se : *“2 Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj...”*, si dhe nenin 127 ku është përcaktuar se: *“1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...”*. ndërlidhur me nenin 82 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“1. Përveç kur parashihet ndryshe me ligj, për llogaritjen e afateve procedurale kundrejt palës, dita e parashtrimit të kërkesës, do të vlerësohet si dita: 1.1. e parashtrimit të kërkesës, në zyrën postare”* dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton ankesa e ankuesve e parashtruar në Këshill me datë 01.01.2025 përmes postës dhe e pranuar me datën 08.01.2025 është e parakohshme, ngase ankuesit kundrejt heshtjes administrative të Komunës së Vitisë në kërkesën e tyre të fundit të datës 12.11.2024 pranuar nga organi i punësimit me datën 19.11.2024 mund të parashtronin ankesë në Këshill **jo më herët se shtatë (7) ditë** dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për përgjigje në kërkesën e tyre të datës 19.11.2024, ngase në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, afati prej 45 ditësh për shqyrtimin e kërkesës së ankuesve të datës 19.11.2024 nga e Komuna e Vitisë, rezulton se dita e fundit ka qenë data 03.01.2025, ndërsa në rrethanat e rastit konkret, ankuesit nuk kanë pritur kalimin edhe të afatit prej shtatë (7) ditësh sikurse përcaktohet me dispozitat e bazës ligjore në fuqi, ndërsa data 01.01.2025 i bie të jetë dita e (12) para kalimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ, e për rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa A.nr.31/2025 është e papranueshme.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit si në **pikën II** të dispozitivit, *sepse:*

Kolegji i Këshillit bazuar në të gjitha provat e lëndës, respektivisht konfirmimit nga Njësia e Burimeve Njerëzore lidhur me statusin e zyrtarëve publik përmes shkresës së datës 07.02.2025 si dhe nga analizimi kontratave të punës dhe akteve të emërimit për ankuesit si në pikën e parë II të dispozitivit të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit, konstaton se këta ankues mbajnë pozita si: “Bartës i Postes”, “Mirëmbajtës i automjeteve”, “Mirëmbajtës i Gjelbërimit”, “Receptionist”, “Librare”, “Receptionist”, “Punëtor teknik elektrikist”, ”.

Kolegji i Këshillit, lidhur me statusin e pozitës së ankuesve të cekur si më lartë, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 5 paragrafi 3, 4 dhe 5 i cili përcakton se:

“3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës. 4. Krijuesja/i dhe performuesja/i i artit dhe kulturës është zyrtarja/i publik që ushtron profesionin e saj/tij artistik në një institucion të artit apo të kulturës; 5. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike”, po ashtu lidhur me nëpunësit e shërbimit publik, krijuesin/en dhe performuesin/en e artit dhe kulturës, si dhe nëpunësit teknik dhe mbështetës, Kolegji i Këshillit ju referua nenit 77 paragrafi 1, nenit 78 paragrafi 2, nenit 88 paragrafi 1, nenit 90 paragrafi 2, dhe nenit 95 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili parasheh: “**77.1.** Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës për nëpunësen/in e shërbimit publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit përkatës të Punës; **78.2.** Për nëpunësen/i ne shërbimit publik të administratës së shërbimit publik në komunë, punëdhënëse është komuna; **88.1.** Nëpunësja/i i shërbimit publik mund të ankohet kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankesës e kanë dhe kandidatët në procedurë rekrutuese në shërbimin publik. **90.2.** Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, punëdhënësi për krijuesin/in dhe performuesin/in e artit dhe kulturës është institucioni i përcaktuar në nenin 78 të këtij ligji. **95.1.** Punëdhënësi në marrëdhënien e punës të nëpunëses/it teknik dhe mbështetës është institucioni përkatës, përmes udhëheqëses/it më të lartë administrativ të institucionit. **95.2.** Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës rregullohet me legjislacionin e punës.”, dhe për rrjedhojë konstatoi se të lartshënuarit nuk kanë statusin e Nëpunësit të Shërbimit Civil, ndërsa marrëdhënia e tyre e punës i nënshtrohet dispozitave të ligjit të punës dhe legjislacionit të veçantë të fushës.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 27 paragrafi 1, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, rithekson faktin se nëpunësit e shërbimit publik, krijuesit dhe performuesit e artit dhe kulturës, si dhe nëpunësit teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontestin administrativ në gjykatën kompetente. Andaj Kolegji i Këshillit, referuar dispozitave të cekura ma lartë, konstaton se pozitat e ankuesve hyjnë në kuadër të nëpunësve të shërbimit publik, e për rrjedhojë duke marr parasysh që këta ankues nuk mbajnë pozitë të nëpunësit të shërbimit civil, atëherë duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që mbi bazë të këtyre pikëpamjeve Kolegji i Këshillit, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.31/2025 të datës 08.01.2025 të parashtruar nga ankuesit, kështu që lënda e ankuesve bie në kompetencë për shqyrtim në Komisionin për Ankesa në Komunën e Vitisë, dhe duke u bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lënda përmes burimeve njerëzore të komunës së Podujevës i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent të përcaktuar si në **pikën III** të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.31/2025,

Ylber Fetahaj

Procesmbajtëse

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, Avokatit Esat Sylja;
- Komunës së Vitisë (Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore dhe Komisionit të Ankesave); si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.